



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:104731
Datë: 15.05.2024
Numri i dokumentit: 05690165

K.DH.SH.II.nr.556/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Ramush Bardiqi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Ex Fis” ShPK, më NRB: 70272163, me adresë në fshatin Vrellë, Komuna e Lipjanit, kundër debitorit “Alko Beton” ShPK me NRB:811382572 me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti i për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2112/22 të datës 25.07.2023, me datë 15.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e bazuar ankesa e kreditorit “Ex Fis” ShPK me adresë në fshatin Vrellë, Komuna e Lipjanit, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2112/22 i datës 25.07.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykatës Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2112/22 të datës 25.07.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Alko Beton” ShPK me seli në Prishtinë, dhe ka shfuqizuar Urdhri Përmbarimor P.nr.636/22, të datës 25.07.2022, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Valdrin Beka.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës Përmbarimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike të Ligjit për Procedurën Përmbarimore të Kosovës dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale të Ligjit për Procedurën Përmbarimore të Kosovës, me propozim që të aprovet ankesa e palës kreditore Ex Fis ShPK me seli në Prishtinë, ndërsa Urdhri Përmbarimor P.nr.636/22 i datës 25.07.2022 të lëshuar nga Përmbaruesi privat Valdrin Beka nga Prishtina të mbetet në fuqi.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit

nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori "Ex Fis" ShPK, me adresë në fshatin Vrellë, Komuna e Lipjanit, me datën 25.07.2022 ka paraqitur propozim për përmbartim, kundër debitorit "Alko Beton" ShPK, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës nr.062-021-000072/22 të datës 08.02.2022 për shumën e borxhit prej 2,440.00€.

Përmbartuesi Privat Valdrin Beka, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit "Ex Fis" ShPK ka caktuar urdhrin P.nr.636/22 të datës 25.07.2022 duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht Faturës nr.062-021-000072/22 të datës 08.02.2022 për shumën e borxhit prej 2,440.00€.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2112/22 të datës 25.07.2023 me të cilin e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit "Alko Beton" Sh.P.K dhe e ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.636/22, të datës 25.07.2022, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Valdrin Beka.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbartimor P.nr.636/22 i datës 25.07.2022, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet se kjo faturë është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitorin, përkatësisht me asnjë provë nuk është dëshmuar se kjo faturë ka të bëjë me debitorin, pasi që e njëjta nuk është e nënshkruar nga ana e tij, dhe nuk mban vulën e debitorit për të vërtetuar se është pranuar në mënyrë të rregullt. Andaj gjykata konstaton se dokumenti i besueshëm mbi bazën e së cilës është iniciuar procedura e përmbartimit nuk ka tipare të përmbartueshmërisë, konform dispozitave nga nenet 29, 37 dhe 38 të LPP-së.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të Gjykatës së Shkallës së Parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se Gjykata e Shkallës së Parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimin të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur kanë konstatuar se fatura në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që fatura

është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, duke qenë se fatura nuk përmban nënshkrimin e debitorit, ndërsa në shkresat e lëndës nuk gjendet ndonjë provë tjetër përmes të cilës mund të vërtetohet se fatura është dorëzuar në mënyrë të rregullt dhe është pranuar nga ana e debitorit. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar kushtet ligjore nga Neni 29 par.3 i LPP, i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar”*.

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se Dhomat e Shkallës së Parë kanë konstatuar drejtë se fatura si dokument i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbartimore, respektivisht është lejuar përmbartimi nuk i plotëson kushtet në mënyrë komulative që duhet t'i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret është edhe qëndrim i kësaj gjykate se qartë rezulton që nuk mund të vërtetohet fakti se fatura është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, duke qenë se fatura nuk përmban nënshkrimin e debitorit, ndërsa në shkresat e lëndës nuk gjendet ndonjë provë tjetër përmes të cilës mund të vërtetohet se fatura është dorëzuar në mënyrë të rregullt dhe është pranuar nga ana e debitorit.

Rrjedhimisht, kjo gjykatë vlerëson se nisur nga fakti se procedura përmbartimore paraqet procedurë formale që i nënshtrohet shqyrtimit formal të dokumenteve përmbartimore dhe/apo atyre të besueshme, rrjedh se si kusht esencial mbi bazën e së cilës mund të lejohet përmbartimi janë tiparet e përmbartueshmërisë së dokumentit të besueshëm e të cilit në rastin konkret i mungojnë kushtet nga Neni 29 par.3 dhe 37 i LPP-së. Së këndejmi, Gjykata thekson se pa plotësimin e këtij kushti dokumenti i besueshëm nuk mund ta ketë fuqinë e titullit përmbartues sepse rezulton se debitori nuk e ka pranuar detyrimin, prandaj dhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përmbartimore duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përmbartimore të iniciohet përmes këtyre dokumenteve.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbartimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e shkallës së dytë

K.DH.SH.II.nr.556/24 dt. 15.05.2024

**Gjyqtari,
Ramush Bardiqi**